

SHPALLEN VENDET VAKANTE
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMI TË INVESTIMEVE:

Në zbatim të Statutit të Agjencisë së AIDA-s, i ndryshuar, neni 25, pika 4, Agjencia Shqiptare e Zhvillimi të Investimeve (AIDA) shpall procedurën për plotësimin e vendit të lirë të kategorisë ekzekutive:

1. SPECIALIST (FINANCË/BUXHET) - Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor” në Shkenca Ekonomike;
- b) Të kenë të paktën 1 vite përvojë pune në fushën e sektorit që mbulon;
- c) Njohuri të mira në ushtrimin e funksioneve të financës.

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- a) Përgatitja e evidencave statistikore;
- b) Kryerja e të gjitha detyrave në lidhje me deklarinimin sipas legjislacionit tatimor;
- c) Përgatitja e listë pagesave të stafit, llogaritja e raporteve mjekësore, dhe lejeve të lindjes, rakoordimet me thesarin, plotësimin e urdhër pagesave;
- ç) Kryen detyrat e magazinës dhe arkës;
- d) Mbajtja e ditarit të shpenzimeve, dhe detyrave të tjera që do të nevojiten Drejtorisë.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a) Kërkesë
- b) Jetëshkrim/CV;
- c) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- ç) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;
- dh) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- ë) Vetë deklarinim të gjendjes gjyqësore;
- f) Vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi, nga punësimi më i fundit;

- Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër:

Do të bëhet on-line, në faqen zyrtare elektronike të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, dhe në adresën e e-mail info@aida.gov.al/ brenda datës 25 tetor 2019.